



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:240295

Datë: 10.10.2024

Numri i dokumentit: 06279208

C.nr.608/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, , të cilin e përfaqëson sipas autorizimit D.H, kundër të paditurit Rr.J , me vendbanim në fshatin K të Komunës së V, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson R.B avokat me seli në V, me objekt kontesti rimbursim i dëmit, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 26.09.2024, me datë 10.10.2024 mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve dhe DETYROHET i padituri Rr.J , që në emër të rimbursimit të dëmit, të shkaktuar në aksidentin e datës 15.06.2017, t'ia paguaj paditëses shumën prej 1,917.00 euro me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data 22.08.2019 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 230.00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja me datë 22.08.2019, ka ushtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurit Rr.J, me objekt kontesti rimbursim i dëmit.

Pretendimet e palëve

Paditësja përmes padisë dhe gjatë seancave ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e saj në tërësi si e bazuar dhe gjykata ta detyroj të paditurin që si përgjegjës i aksidentit të datës 15.06.2017, ta rimbursoj paditësen për kompensimin që paditësja i ka bërë të dëmtuarit nga ky aksident S. L. Ka shtuar se pas aksidentit për faktin se i padituri e ka shkaktuar aksidentin pa mbulesë siguruese, konkretisht me afat të skaduar të sigurimit dhe për këtë arsye duke u bazuar në nenin 18 par 4, të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (LSDA), përgjegjësia për dëmin bie mbi të paditurin që ka vozitur pa mbulesë siguruese. Në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i paditëses ka theksuar se gjykata duhet ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses sepse nga ekspertiza e komunikacionit është konstatuar në mënyrë të qartë se përgjegjës për shkaktimin e aksidentit është vetëm i padituri.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë në shumën prej 30.00 euro për taksën e padisë dhe shumën prej 200.00 euro për ekspertizën e komunikacionit.

I padituri përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar me përgjigje në padi ka theksuar se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, me arsyetimin se nuk ka aktgjykim penal apo ekspertizë me të cilat vërtetohet fajësia e të paditurit për shkaktimin e këtij aksidenti. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se kërkojnë nga gjykata që ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, me arsyetimin se ekspertiza e komunikacionit është abstrakte dhe e bazuar vetëm në raportin e policisë dhe skicën e vendit të ngjarjes, që sipas përfaqësuesit të të paditurit nuk janë prova materiale, ka shtuar se eksperti i komunikacionit ka konstatuar se i padituri nuk ka qenë i vëmendshëm në momentin e shkaktimit të aksidentit por që këtë konstatim e ka bërë pa kurrfarë dëshmie, fakti apo prove, duke e mos e ditur fare shpejtësinë e lëvizjes së pjesëmarrësit tjetër në komunikacion (të dëmtuarit)

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për padi dhe pjesëmarrje në seanca sipas tarifës së Odës së Avokatëve.

Provat

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka administruar këto prova: Raporti policor 2017-BR-383, i datës 15.06.2027, Urdhër transferi i datës 03.10.2017, për dëmin material në veturë, ne emër të të autorizuarit të dëmtuarit H. O– Servis O, Ujdia jashtëgjyqësore e datë 28.09.2017, Vendimi i

Komisionit të Shkallës së parë i paditëses së datës 23.08.2017, Raporti policor dhe skica e datës 15.06.2017, Konfirmimi i sigurimit i datës 30.06.2017, Urdhër transferi i datës 05.09.2017, për dëmin jo material, në emër të të autorizuarit të të dëmtuarit B M, Ujdia jashtëgjyqësore për dëmin jo material e datës 23.08.2017, Vendimi i Komisionit të Shkallës së parë i paditëses, për dëmin jomaterial , i datës 16.08.2017, Vlerësimi mjekësor i datës 17.07.2017, i mjekut cenzor të BKS dhe Ekspertiza e komunikacionit e datës 17.08.2024, e punuar nga eksperti i komunikacionit B.S.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe kërkesëpadisë, provave të propozuara si dhe përgjigjes në padi në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë andaj e aprovoi në tërësi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në mes palëve nuk ishte kontestues fakti se me datë 15.06.2017, ishte shkaktuar aksidenti i komunikacionit ku ishte përfshirë automjeti i të paditurit me targa të regjistrimit 02-908-CL, të cilin e ka drejtuar i paditur dhe vetura e të dëmtuarit S.L dhe se në ditën e shkaktimit të aksidentit, i padituri nuk ka pasur mbulesë siguruese. Kontestuese po ashtu nuk ishte edhe fakti se i dëmtuari është kompensuar për dëmet e pësura në këtë aksident (Për këtë arsye nuk do të elaborohen secila nga provat e administruara që kanë të bëjnë me raportin në mes të dëmtuarit dhe paditëses)

Kontestuese në mes palëve ishte fakti nëse i padituri ishte përgjegjës për shkaktimin e aksidentit dhe nëse e paditura ka të drejtë të kërkoj rimbursim nga ana e të paditurit.

Nga Raporti policor i aksidentit të trafikut me numër 2017-BR-383, i datës 15.06.2027, së bashku me skicën, është konstatuar se dyshohet se deri te aksidenti ka ardhur derisa dy automjetet kanë qenë duke levizuar në Rr. në fshatin K në drejtime të kundërta-përballë kalimi dhe kur kanë arritur në afërsi të shtëpisë së J.F , automjeti “A”, e humb kontrollin duke mos përshtatur shpejtësinë e kushteve të rrugës, i cili kalon në shiritin e kundërt të lëvizjes dhe me pjesën e përparme e godet automjetin “B”, në anën e majtë në pjesën e përparme, ku pos dëmeve materiale, lëndime trupore pëson vozitësi i veturës “B”.

Nga Urdhër transferi i datës 03.10.2017, për dëmin material në veturë, ne emër të të autorizuarit të dëmtuarit H.O– Servis O është vërtetuar se paditësja, në bazë të marrëveshjes jashtëgjyqësore

me të dëmtuarin, të datës 28.09.2017, ka urdhëruar që përfaqësuesit të të dëmtuarit S.L, në emër të kompensimit material t'i paguhet shuma prej 1,233.00 euro, kurse nga Urdhër transferi i datës 05.09.2017, në bazë të marrëveshjes jashtëgjyqësore me të autorizuarin e të dëmtuarit të datës 23.08.2017, paditësja ka urdhëruar që përfaqësuesit të të dëmtuarit S.L, në emër të kompensimit jo material t'i paguhet shuma prej 684.00 euro, me çka vërtetohet se paditësja i'a ka kompensuar të dëmtuarit në shumën e përgjithshme prej 1,917.00 euro.

Nga Konfirmimi i sigurimit i datës 30.06.2017, është vërtetuar se i padituri ka pasur mbulesë siguruese nga data 30.10.2015-30.10.2026.

Nga Ekspertiza e komunikacionit e datës 17.08.2024, e punuar nga eksperti i komunikacionit B.S, është konstatuar se në vendin ku është shkaktuar aksidenti kontestues. Shpejtësia e lëvizjes ka qenë e kufizuar në 50 km/h dhe se ka qenë rrugë me kthesë, por që në vendin e aksidentit nuk ka pasur gjurmë të frenimit. Po ashtu është vlerësuar se i padituri përkundër që ka qenë duke lëvizur në rrugë me kthesë, nuk përkushtohet sa duhet që t'ia përshtat shpejtësinë e lëvizjes me kushtet e rrugës në kthesë dhe në këtë mënyrë gjatë përball kalimit me veturën e të dëmtuarit e humb kontrollin e veturës dhe kalon në shiritin e kundër qarkullues dhe e godet në pjesën e përparme veturën e të dëmtuarit, kjo e vërtetuar nga skica e vendit të ngjarjes, ku pika e goditjes është në shiritin në të cilin ka qenë duke lëvizur vetura e të dëmtuarit dhe për këto arsye eksperti ka arritur në përfundim se aksidenti i datës 17.08.2024 është shkaktuar pas lëshimeve të bëra nga i padituri. Duhet theksuar se eksperti në ekspertizë emrin e të paditurit si Rr.R, por në seancën e datës 26.09.2024, ka theksuar se ka qenë gabim teknik sepse në vend të mbiemrit J, e ka shkruar emrin e babit të të paditurit (Rrahim) si mbiemër të tij.

Me nenin 136,1 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (LMD) është përcaktuar që *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, me nenin 137 të këtij ligji është paraparë që *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*, kurse me nenin 960 të po këtij ligji thuhet se *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguroresin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin”*

Po ashtu me nenin 18 par 4 i Ligjit 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia parashihet që “ *Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja*”, kurse me par 4, të këtij neni thuhet se “*Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat*”.

Se i padituri është përgjegjës për shkaktimin e aksidentit të datës 15.06.2017, në të cilin aksident i janë shkaktuar dëme materiale dhe jo materiale të dëmtuarit S.L , gjykata e ka vërtetuar nga Raporti i aksidentit i Policisë së Kosovës me 2017-BR-383, i datës 15.06.2027, së bashku me skicën e vendit të ngjarjes, e posaçërisht edhe nga ekspertiza e komunikacionit e datës 17.08.2024, e punuar nga eksperti i komunikacionit B.S , e cila ekspertizë për gjykatën është bindëse dhe profesionale, që është punuar duke u bazuar në të gjitha shkresat e lëndës dhe ka përkrahur në detaje lëshimet e të paditurit në shkaktimin e aksidentit të datës 15.06.2017, duke arritur në konstatimin se aksidenti ka ndodhur për shkak të lëshimeve të të paditurit, për shkak se i njëjti nuk e ka pasur kujdesin e duhur në lëvizjen në rrugën me kthesë, çka ka ndikuar që ai të kalojë në shiritin e kundërt të lëvizjes, në të cilin shirit e ka goditur veturën e të dëmtuarit.

Prandaj për gjykatën këto prova të lartcekura janë të mjaftueshme për të vërtetuar se përgjegjës për aksidentin e datës 15.06.2017, ka qenë tani i padituri dhe sipas Konfirmimit të sigurimit i datës 30.06.2017, është vërtetuar se i padituri ketë aksident e ka shkaktuar me veturën e cila nuk ka pasur mbulesë siguroese.

Në anën tjetër, pretendimi i përfaqësuesit të të paditurit se i padituri nuk është përgjegjës për aksidentin e datës 15.06.2017 sepse ndaj tij nuk ka prova për ndonjë aktgjykim penal të formës së prerë për gjykatën është tërësisht i pabazuar sepse nga provat e administruara në këtë shqyrtim kryesor është vërtetuar mjaftueshëm përgjegjësia e të paditurit në shkaktimin e këtij aksidenti. Për gjykatën i pabazuar është edhe pretendimi tjetër i përfaqësuesit të të paditurit se ekspertiza është e bazuar vetëm në raportin e aksidentit dhe skicën e vendit të ngjarjes, të cilat i ka vlerësuar se nuk janë prova materiale, ngase ky pretendim është jo i saktë sepse ashtu siç është theksuar më lartë, gjykata e ka vlerësuar si profesionale ekspertizën e komunikacionit sepse e njëjta është e bazuar nga të gjitha shkresat e lëndës, duke përfshirë edhe raportin policor dhe skicën e vendit të ngjarjes, që janë punuar ditën e shkaktimit të aksidentit nga vendi i ngjarjes.

Prandaj, pasi sipas nenit 18 par 1 të LSDA-së, paditësja duhet t'i kompensoj të dëmtuarit nga dëmi që i shkaktohet nga mjetet motorrike të pasiguruara, të cilin dëm paditësja me Urdhër transferin e datës 05.09.2017 dhe Urdhër transferin e datës 03.10.2017, e ka kompensuar të dëmtuarin S.L, në shumën e përgjithshme prej 1,917.00 euro, gjykata duke u bazuar në nenin 18 par 4 të LSDA-së, ku thuhet se *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*, dhe pasi në këtë procedurë gjyqësore është vërtetuar se i padituri është përgjegjës për këtë aksident të shkaktuar dhe se aksidentin e ka shkaktuar me makinën e tij e cila nuk ka pasur mbulesë siguruese, gjykata në dispozitivin e këtij aktgjykimi, duke u bazuar edhe në nenin 960 par 1 të LMD-së, të paditurin e ka detyruar që shumën të cilën paditësja e ka kompensuar të dëmtuarin (1,917.00 euro) t'ia rimbursoj paditëses.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 par.2 të LMD-së dhe Mendimin juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 265/2020 i datës 02.12.2020 paditëses i'a njohu edhe të drejtën në kamatë ligjore, në lartësi prej 8% në vit, duke llogaritur nga data 22.08.2019, si dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së sipas ku përcaktohet që *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtarë gjyqfituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t'ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”* dhe atë në shumën prej 30.00 euro, në emër të pagesës së taksës gjyqësore për padinë e parashtruar dhe shumën prej 200.00 euro në emër të ekspertizës së komunikacionit.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:240295, C.nr.608/2019, me datë 10.10.2024

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.